

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije-Ministry of Economy

DATE/A	17.04.2025
REFERENC-Ë:	Për miratim
PËR / ZA / TO	Znj. Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë
CC:	
PËRMES / PREKO /THROUGH	Z.Skender Sallahi, Drejtor i Departamentit të Minerave
NGA / OD / FROM	Besim Mavraj, Udhëheqës i Divizionit të Politikave Minerare
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT	Raporti i Progresit për vitin 2024 i Programit për Zbatimin e Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025

Të nderuar,

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (UA) 07/18 për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Sipas kërkesës së Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) në Ministrinë e Ekonomisë (ME), dhe sipas kërkesës së ZPS/ZKM për përgatitjen e raporteve vjetore të zbatimit të dokumenteve strategjike për vitin 2024. Ju lutem gjeni për miratim;

Raportin e Progresit për vitin 2024 i Zbatimit të Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025.

Raporti i Progresit për vitin 2024 është Raport Vjetor i Zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, i cili është përgatitur nga Departamenti i Minerave (DM), si kryesues i Grupit Koordinues (GK), ndërinstitutional për të siguruar monitorimin e rregullt të Zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 - 2025 dhe përshkruan progresin e realizimit të objektivave, masave dhe aktiviteteve gjegjësisht projekteve, që kanë për qëllim Zbatimin e Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025.

Raporti i Progresit për Vitin 2024 është përgatitur bazuar në Ligjin Nr. 03/l-163. për Minierat dhe Mineralet, përkatësisht Ligjin Nr. 04/l-158, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/l-163 për Minierat dhe Mineralet dhe sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) 07/18 për Planifikimin. Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit dhe Manualit për Planifikim dhe Monitorim të dokumenteve strategjike.

Pas plotësimit të komenteve të fundit nga përfaqësuesit e ZPS-së, si pjesë e Grupit Koordinues (GK) ndërinstitutional, drafti i Raportit të Progresit për vitin 2024 të Zbatimit të Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025 konsiderohet si drafti i finalizuar dhe mund të procedohet për miratim nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë (ME) sipas;

Udhëzimit Administrativ (UA) 07/18 për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit:

Nenit 16

4. Raporti miratohet nga Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë përgjegjëse për dokumentin strategjik dhe do të diskutohet nga përfaqësuesit e institucioneve kryesore pjesëmarrëse nën kryesimin e ZPS- së për miratim final. Në rast të mosmarrëveshjeve të pazgjidhura, çështja duhet t'i nënshtrohet vendimmarrjes në Komisionin për Planifikim Strategjik (KPS). Raporti final i miratuar duhet të publikohet,

Nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) në Ministrinë e Ekonomisë (ME). Jemi njoftuar se Ministria e Ekonomisë (ME) ka një afat që deri më datë 31 maj 2025 dokumenti pas miratimit të dërgohet në ZPS/ZKM.

Bashkëngjitur gjeni:

- Versionin final të Raportit të Progresit për vitin 2024 i Zbatimit të Strategjisë Minerare, për periudhën 2012-2025.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

**Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije
Ministry of Economy**

Raporti i Progresit

**Për Vitin 2024 i
Zbatimit të Strategjisë Minerare, për
periudhën 2012-2025**

Prishtinë, 2025

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	3
II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE.....	4
II.1. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT:	5
III. TREGUESIT KRYESORË TË NDIKIMIT TË MASAVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE.....	14
IV. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE.....	16
V. SHTOJCA 1- PJESA MATRICORE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2024, TË STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2012-2025.....	19

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovë përbën kornizën themelore, në bazë të së cilës përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore të sektorit minerar. Strategjia Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025 përcakton politikën dhe masat për zhvillimin e sektorit minerar në dobi të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale.

Raporti Vjetor i Progresit është bazuar në monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së treguesve për Strategjinë Minerare deri në vitin 2024, mbi progresin dhe realizimin e projekteve/aktiviteteve të planifikuara sipas koston dhe kohës së realizimit, gjegjësisht aktiviteteve, të parapara dhe përcakton subjektet përgjegjëse për implementim.

Në Raport të Progresit janë përfshirë aktivitetet në kuadër të secilës shtyllë/objektiv strategjik, është paraqitë afati kohor i realizimit, institucioni përgjegjës dhe mbështetës për zbatimin e aktivitetit, kostoja e realizimit të aktivitetit dhe kostoja e përgjithshme e planifikuar për periudhën kohore, si dhe burimi i financimit.

Ky raport identifikon progresin e realizuar, dhe identifikon sfidat për mosrealizimin e projekteve/aktiviteteve të caktuara. Identifikimi i sfidave do të ndihmojë në lehtësimin e punës në adresimin e çështjeve të cilat mund të konsiderohen si pengesë për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit, dhe kjo do të ndihmojë drejtë përmirësimit të planifikimit, realizimit dhe analizimit më të thukët sa i përket planifikimit të koston dhe kohës së realizimit të projekteve.

Rrjedhimisht, Raporti Vjetor i Progresit do të shërbejë edhe si bazë për rishikimin e politikave zhvillimore minerare që do të mund të reflektoheshin në rishikimin e Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025.

Raportit i Progresit për vitin 2024, lidhur me zbatimin e Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025 është përgatitur në përputhje me nenin 73, të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe nenin 44, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet dhe kapitullin 8, paragrafi 8.1 dhe 8.2 të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Ministria e Ekonomisë (ME), Departamenti i Minierave (DM) ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit për vitin 2024, ndërsa, në hartimin e këtij dokumenti kanë marrë pjesë institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit minerar siç janë: ME, KPMM, KEK ShA dhe "TREPÇA" ShA.

Fillimisht, Departamenti i Minierave (DM) ka hartuar modelin e raportimit përmes tabelave, ku janë paraqitur projektet e parapara për vitin 2024. Modeli i monitorimit dhe raportimit është bërë përmes tabelave me emërtimet e projekteve /aktiviteteve të planifikuara për tu realizuar gjatë viteve të fundit. Në tabela janë identifikuar objektivat dhe veprimet, afati i fundit, burimi i financimit, institucioni udhëheqës dhe mbështetës, produkti (Output), referenca në dokumente p.sh. Plani i Punës së

Qeverisë (PPQ), Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA) dhe progresi në zbatim.

1.1. Qëllimet Strategjike të Dokumentit

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe në harmoni me mjedisin e sektorit minerar është i rregulluar me Strategjinë Minerare që bazohet në katër (4) shtylla themelore që në Raportin e Progresit do të identifikohen si qëllime apo objektiva strategjike të dokumentit.

Qëllimet strategjike në këtë dokument janë të identifikuar si:

Qëllimi/Objektivi Strategjik: Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerale dhe tërheqje të investimeve;

Qëllimi/Objektivi Strategjik: Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin minerar;

Qëllimi/Objektivi Strategjik: Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit;

Qëllimi/Objektivi Strategjik: Përkujdesja për mjedisin.

Realizimi i Qëllimeve/Objektiveve Strategjike të dokumentit strategjik, synon zbatimin e reformave kyçe në këtë sektor duke plotësuar në përpikëri kërkesat që kërkohen nga synimet dhe qëllimet strategjike. Me këtë qëllim në vitin 2024 janë planifikuar të realizohen trembëdhjetë (13) objektiva/aktivitete, të cilat janë përshkruar në Shtojcën 1 më poshtë.

II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Zbatimi i masave të përcaktuara në Strategjinë Minerare për periudhën 2012-2025, ka pasur ndikim në sektorin minerar, qoftë në rritjen e kapaciteteve prodhuese, ngritjen e kapaciteteve të reja dhe bashkëkohore operuese, duke ndikuar në rritjen e performancës së përgjithshme.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025, Ministria e Ekonomisë (ME), respektivisht Departamenti i Minierave (DM), ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit, ndërsa, në hartimin e këtij dokumenti kanë marrë inputet dhe janë identifikuar rreziqet për të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. Si pjesë e kësaj do të vazhdoj bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit minerar në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

II.1. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT

Mund të konstatohet se ngecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregojnë për domosdoshmërinë e marrja e hapave konkret në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e

këtij sektori. Roli i institucioneve përgjegjëse të sektorit mineral, por edhe i ndërmarrjeve minerare në planifikimin e aktiviteteve dhe projekteve është jetik në suksesin dhe zhvillimin e sektorit mineral.

Në këtë drejtim duhet forcuar kapacitete institucionale përmes ngritjeve profesionale dhe investimeve në zhvillimin e teknologjisë. Po ashtu në suksesin e sektorit rol të rëndësishëm luan transparenca dhe lehtësimi i proceduarve burokratike. Në këtë drejtim duhet krijuar mundësitë institucionale që investorët të kenë qasje të lehtë dhe të shpejt në interesat e tyre për investime duke pasur një adresë të qartë ku mund të drejtojnë kërkesat e tyre. Harmonizimi i ligjeve dhe heqja e paqartësive ligjore, bashkëpunimi me i ngushtë dhe i vazhdueshëm, hulumtimi i mundësive të reja për donacione dhe tërheqje të fondeve janë disa nga hapat e domosdoshme që duhet të ndërmerren në vitet në vazhdim në këtë drejtim.

Realizimi i prodhimitarisë së lëndëve minerale

Duhet theksuar se e veçanta e mineraleve si produkte ekonomike është në kompleksitetin e ekonomisë së lëndëve minerale dhe biznesin e minierave (Vogely, 1985; Strauss, 1986). Mineralet janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë dhe ndryshe nga produktet bujqësore apo pyjore, nuk mund të riprodhohen ose të zëvendësohen. Prandaj, një vendburim i mineraleve mund të konsiderohet si një aset shterues, prodhimi i të cilit është i kufizuar në zonën në të cilën ai ndodhet. Këta faktorë vendosin kufizime në një ndërmarrje minerare në fushat e praktikave të biznesit, financimit dhe praktikave të prodhimit. Për shkak se asetet minerale vazhdimisht shkojnë duke u shterur, ndërmarrjet minerare ose duhet të zbulojnë rezerva shtesë ose t'i kërkojnë ato duke i blerë për të qëndruar në biznesin e sektorit mineral.

Në vitin 2024, sikurse edhe në vitet paraprake, shumica e ndërmarrjeve që merren me shfrytëzimin e gurit të fortë, rërës dhe zhavorit nuk po arrijnë të përmbushin planifikimet e tyre të prodhimit. Në bazë të analizave të bëra mund të konstatohet se arsyet kryesore për dështim të këtyre ndërmarrjeve janë:

- Planifikimi jo real i ndërmarrjeve lidhur me shfrytëzimin dhe përpunimin e lëndës minerale;
- Mungesa e kapitalit të ndërmarrjeve për të investuar në fazën e hulumtimit për të evituar dështimin në fazat e mëvonshme të shfrytëzimit për shkak të cilësisë së dobët të mineralit;
- Çmimi i lartë i energjisë po shkakton vështirësi të mëdha në aktivitetet e ndryshme minerare;
- Konkurrenca (jo gjithëherë e lirë) dhe tregu jo i qëndrueshëm për këto produkte;
- Aktivitetet minerare të jashtëligjshme, etj.

Analizë e problemeve në sektorin mineral

Sa i përket problemeve në sektorin e industrisë minerare vlen të theksohet se shfrytëzimi i lëndëve minerale është një sfidë e cila përcillet me shumë probleme qofshin ato njerëzore, organizative, pajisjet e amortizuara, rritja e çmimeve të energjisë, të kapitalit investues, menaxhimit jo të duhur etj. Përveç këtyre, viti 2024 është përcjell edhe nga ngjarje të rëndësishme në arenën ndërkombëtare (luftëra të ndryshme, vështirësi ekonomike-inflacioni, ndikimet e ndryshme klimatike etj). Të cilat në disa aspekte nuk kanë shkuar në favor të industrisë minerare. Anasjelltas, industria minerare ka potencialin për të krijuar mundësi të punësimeve afatgjata.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila shfrytëzon lëndën minerale energjetike-lignit, edhe këtë vit ka kaluar kryesisht mirë me aktivitetet e shfrytëzimit dhe sipas raportimeve nuk ka pasur probleme të theksuara që kishin me pengu shfrytëzimin e minierës.

Ndërmarrja “Trepça” do të hapë perspektiven e zhvillimit të saj duke rritur kapacitetet e prodhimit dhe realizimin e një produktiviteti më të lartë. Përkundër angazhimeve kjo ndërmarrje ende ballafaqohet me disa vështirësi të së kaluarës si ; mosha e vjetër e minatorëve, pajisjet e vjetruara, etj.

Ndërmarrja “Newco Ferronikeli Complex L.L.C.” në vitin 2024, sipas raportimeve nuk ka shfrytëzuar lëndë minerale por vlen të theksohet se kjo ndërmarrje ka imponuar lëndë minerale nga vendet jashtë Kosovës. Ndërmarrja në fjalë nuk ka mundur ta bëjë bartjen e kontrollit përkundër se “Yildirim Kosovo Mining Investment L.L.C” ka blerë aksionet nga ndërmarrja “NKL Limited” e cila kishte në pronësi gjegjësisht në menaxhim “Newco Ferronikeli Complex L.L.C”.

Po ashtu shfrytëzimi i mineraleve jometalorë ka vështirësi të ndryshme të cilat e pengojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve minerare.

Tregu i paqëndrueshëm për lëndët minerale, konkurrenca për shkaqe të shumë operatorëve, krijojnë të ndërmarrjet probleme të tilla financiare të cilat me vështirësi i përballojnë.

Nga sa u tha më lartë, mund të konstatojmë se, si rezultat i këtyre problemeve ndërmarrjet nuk kanë mundur të realizojnë planifikimet e tyre të prodhimtarisë në shfrytëzimin e lëndëve minerale për të cilat kanë licencat e shfrytëzimit. Planifikimet vjetore nga ndërmarrjet deri tani asnjëherë nuk kanë qenë reale dhe kjo po pamundëson shfrytëzimin e të dhënave të tilla për projekt – planin njëvjeçar (1) të menaxhimit të resurseve minerale.

Vlen të theksohet se nga viti i kaluar kanë filluar me planifikime dhe raportime me reale të shfrytëzimit të lëndës minerale për vitin vijues, shpresojmë se në një të ardhme të afërt të kemi planifikime reale.

Analizë e realizimit të prodhimtarisë së lëndëve minerale

Analizimi i planifikimit për vitin vijues është bërë duke marrë parasysh trendin e shfrytëzimit të tri (3) viteve paraprake për vitet 2021-2024. Deri në kohën e bërjes së Projekt-Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale (fundi i vitit 2024), ndërmarrjet sjellin raportimet për tremujorët (3): TM₁, TM₂, dhe TM₃ të vitit 2024. Nga këta tremujor (3) është nxjerrë e mesmja matematikore për TM₄, dhe më pastaj në planifikim për vitin 2025 kemi marr parasysh edhe vitin 2024 si të kompletuar. Duke u bazuar në atë çfarë u tha më lartë, për të pasur një planifikim të përafërt për vitin vijues është shfrytëzuar forma e grafikut e emëruar si “Mesatarja e lëvizshme e shfrytëzimit”, i cili grafik mundëson që planifikimi për vitin vijues për lëndë të veçanta minerale të jetë shumë i përafërt dhe paraqet gjendjen më reale të mundshme.

Realizimi i prodhimit për lëndë minerale energjetike

Qymyri (linjiti) si mineral energjetik është resursi më i rëndësishëm i Republikës së Kosovës, ngase furnizimi më energji elektrike pothuajse tërësisht varet nga kjo lëndë minerale. Prodhimi i energjisë elektrike nga qymyri arrin rreth nëntëdhjetë për qind (90%) kurse pjesa tjetër prej rreth dhjetë për qind (10%) është nga BRE-të. Resurset e vlerësuara të qymyrit në gjithë Kosovën janë rreth 12.5 miliardë tonë, që nga aspektin ekonomik konsiderohen me leverdi për tu shfrytëzuar. Aktualisht pranë KPMM-së për shfrytëzimin e lëndëve minerale energjetike është e licencuar vetëm “Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)” e cila bënë shfrytëzimin sipërfaqësor të linjtit për nevojat e prodhimit të energjisë elektrike të vendit. Në vijim është paraqitur tabela me diagramet e shfrytëzimit të qymyrit (linjit) për vitet 2021-2024.

Tab.1. Gjendja e rezervave të mineraleve energjetike 2021-2024

Tabela e gjendjes së rezervave minerale energjetike për vitet 2021-2024									
Lënda minerale	Aktiviteti	2021	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2022	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2023	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2024	Raporti Planifikim - Shfrytëzim
Lignit (t)	Rezervat e shfrytëzueshme	133,653,848.00	94.84	169,285,120.65	92.72	162,214,072.60	85.09	156,280,053.60	87.91
	Planifikimi	9,000,000.00		9,000,000.00		8,310,000.00		9,000,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	8,535,435.00		8,344,548.00		7,071,048.05		7,912,025.33	




Fig.1. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale energjetike për vitet 2021-2024




Fig.2. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale energjetike të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2021-2024.

Realizimi i prodhimit për lëndë minerale metalore

Shfrytëzimi i lëndëve minerale metalore edhe këtë vit sikurse vitet paraprake nuk ka shkuar sipas planifikimeve të parapara nga ndërmarrjet për shumë arsye disa nga të cilat janë përmendur më lartë të analiza e sektorit mineral.

Tab.2. Gjendja e rezervave minerale metalore për vitet 2021-2024

Tabela e gjendjes së rezervave minerale metalore për vitet 2021-2024									
Lënda mineral e	Aktivitetit	2021	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2022	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2023	Raporti Planifikim - Shfrytëzim	2024	Raporti Planifikim - Shfrytëzim
Pb-Zn	Rezervat e shfrytëzueshme	9,003,969.30	83.80	14,312,785.97	36.33	14,131,396.47	53.99	14,018,776.99	50.48
	Planifikimi	312,520.00		648,490.04		335,970.04		297,484.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	261,894.00		235,579.20		181,389.50		150,159.31	
Ni-Co	Rezervat e shfrytëzueshme	19,349,950.77	52.60	19,315,665.16	3.73	19,314,296.46	0.29	19,314,296.46	0.00
	Planifikimi	865,506.30		918,183.60		470,870.00		720,323.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	455,242.00		34,285.61		1,368.70		0.00	
Cr2O3	Rezervat e shfrytëzueshme	233,009.18	432.61	233,009.18	0.00	233,009.18	0.00	233,009.18	0.00
	Planifikimi	3,850.00		60,000.00		60,000.00		60,000.00	
	Rezervat e shfrytëzuara	16,655.62		0.00		0.00		0.00	




Fig.3. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale metalore për vitet 2021-2024




Fig.4. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale metalore të planifikuar dhe shfrytëzuara për vitet 2021-2024

Realizimi i prodhimit për lëndë minerale jometalore

Në tabelat dhe grafikët e më poshtëm është paraqitur sasia e shfrytëzuar sipas lëndëve minerale jometalore. Përqindja (%) e realizimit të prodhimitarisë është bazuar në raportin në mes të planifikimit dhe realizimit sipas raportimit të ndërmarrjeve.

Siç shihet nga tabela nr. 9, gjendja e rezervave të mineraleve jometalore për periudhën 2021-2024, vërehet se, në viti 2024 kemi rritje të shfrytëzimit të disa lëndëve minerale jometalore ndërsa kemi rënie në disa lëndë minerale varësisht nga kërkesat e tregut gjë që është normale dhe se kjo ndodhë pothuajse çdo vit. Një çështje e cila vlen të theksohet është edhe fakti se KPMM-ë kishte mbetur pa bord nga viti 2014 herë pas herë në vite të tera ka pas mungesë të bordit funksional për vendimmarrje, deri me ardhjen e bordit më 16 maj 2024, dhe si rezultat disa ndërmarrje nuk kanë mundur të pajisen me licencat përkatëse apo edhe të vazhdojnë licencat e skaduar të shfrytëzimit.




Fig.5. Diagrami i gjendjes së rezervave minerale jometalore për vitet 2021-2024, më prodhimtari më të vogël se 100,000m³




Fig.5.(a). Diagrami i gjendjes së rezervave minerale jometalore për vitet 2021-2024, më prodhimtari më të vogël se 100,000m³




Fig.5.(b). Diagrami i gjendjes së rezervave të gëlqerorit për vitet 2021-2024, më prodhimtari më të madhe se 100,000m³




Fig.6. Diagrami i gjendjes së rezervave të lëndës minerale jometalore të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2021-2024, më prodhimtari më të vogël se 100,000m³




Fig.6.(a). Diagrami i gjendjes së rezervave të lëndës minerale jometalore të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2021-2024, më prodhimtari më të vogël se 100,000m³




Fig.6.(b). Diagrami i gjendjes së rezervave të gëllçorit dhe mërgel-ës të planifikuara dhe shfrytëzuara për vitet 2021-2024, më prodhimtari më të madhe se 100,000m³

Eksporti dhe importi i lëndëve minerale

Më poshtë në Tab.10. dhe Tab.11. janë paraqitur shënimet e pranuar nga Doganat e Republikës së Kosovës në lidhje me sasinë e lëndës minerale të eksportuar dhe importuar e të cilat kanë emërtime të ndryshme nga ato që ne i kemi në bazën e shënimeve. Nga këto të dhëna vërehet se në eksport mbizotërojnë xeherorët dhe koncentratet e plumbit, zinkut, kromit etj., ndërsa në import xeherorët dhe koncentratet e nikelit.

Tab.3. Sasia e lëndës minerale-koncentratit të eksportuar në periudhën më 1 janar 24 deri më 17 dhjetor 2024.

EX1-Eksporti i rregullt () - Te dhenat Komerciale sipas kodit tarifar (HS-10)				
Prej: 2024-01-01 deri: 2024-12-17				
2024	EX1		Neto Kg	Vlera
		2601200000 - Pirit i pjekur i hekurit		
		2604000000 - Xeherore dhe koncentrate nikelit	3,448,680.00	75,767.06
		2606000000 - Xeherore dhe koncentrate alumini	28,967.00	602.81
		2607000000 - Xeherore dhe koncentrate plumbi	137,740.00	31,579.81
		2608000000 - Xeherore dhe koncentrate zinku	5,349,532.00	9,425,591.59
		2610000000 - Xeherore dhe koncentrate kromi	6,140,210.70	4,467,419.00
		2616900000 - Te tjera	2,511,498.00	526,852.89
		2617900000 - Te tjera	78.25	578.17
		2618000000 - Zgijra të granuluara (rërë zgjyre) të dalë nga përpunimi i hekurit dhe çelikut	874.58	73.80
		2620110000 - Shufra të forta zinku	911,386.00	107,792.42
		2620300000 - Që përmbajnë kryesisht baker	48,270.00	89,762.51
		Total	24,000.00	3,120.00
		Total	18,601,116.53	14,748,940.06
			18,601,116.53	14,748,940.06

Tab.4. Sasia e lëndës minerale-koncentratit të importuar në periudhën më 1 janar 24 deri më 17 dhjetor 2024.

IM4-Importi i rregullt () - Te dhenat Komerciale sipas kodit tarifar (HS-10)				
Prej: 2024-01-01 deri: 2024-12-17				
2024	IM4		Neto Kg	Vlera
		2604000000 - Xeherore dhe koncentrate nikelit	73,094,590.00	5,146,743.96
		2606000000 - Xeherore dhe koncentrate alumini	6,157,420.00	308,602.77
		2610000000 - Xeherore dhe koncentrate kromi	4,192,860.00	59,147.29
		2621900000 - Te tjera	5,990.00	2,996.38
		Total	83,450,860.00	5,517,490.40
		Total	83,450,860.00	5,517,490.40

Aktivitetet e jashtëligjshme

Aktiviteti i veprimtarisë së jashtëligjshme është një çështje sfiduese për KPMM-në. Në vitin 2024 janë marr aksione të përbashkëta të inspektoratit të KPMM-së me institucionet tjera të vendit si MMPH-në, APK-në, Policinë e Republikës së Kosovës dhe Inspektoratet tjera me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie të jashtëligjshme, duke paraqitur të dhënat për aktivitetet e jashtëligjshme minerare për vitin 2024. Më poshtë në tabelë 5.janë paraqitur të dhënat për aktivitetet e jashtëligjshme për vitin 2024.

Tab.5. Operimet ilegale sipas llojit të lëndës minerale

Operimet ilegale sipas llojit të lëndës minerale	Evidenca
Industriale	2
Guri të fortë	4
Rërë dhe zhavore	6
Rërë kuarcore	0
Qymyri (linjit)	1
Fabrikë përpunimi të lëndës minerale /seperacion	12
Gjithsej	25

Për të gjitha shfrytëzimet ilegale të resurseve janë ngritur kallëzime penale, janë dhënë gjopa administrative ndaj personave fizik gjegjësisht ndërmarrjeve për aktivitete të jashtëligjshme minerare dhe të aktiviteteve të veçanta, si dhe lëndë të caktuara kanë shkuar në procedurë përmbartimore. Si pasojë e aktiviteteve të jashtëligjshme minerare (shfrytëzimi i lëndëve të ndryshme minerale) përveç humbjeve në resurse po mbesin edhe degradime të mëdha dhe të rrezikshme mjedisore e veçanërisht përgjatë brigjeve të lumenjve, ku rehabilitimi i tyre do të ketë një kosto të lartë. Duhet theksuar se kjo veprimtari është në kundërshtim të plotë me konkurrencën e lirë dhe mbrojtjen e saj e cila paraqet një segment vital për ekzistimin e ekonomisë së tregut (Ligji Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e konkurrencës). Nga këto aktivitete të jashtëligjshme po pësojnë humbje financiare ndërmarrjet e licencuara të cilat i përmbushin të gjitha obligimet ligjore, Buxheti i Republikës së Kosovës, dhe po ashtu konsiderohen dëme financiare edhe përdorimi i materialeve jo cilësore në ndërtimin e infrastrukturës rrugore.

Aktivitetet e rikultivimit dhe mbylljes së minierave/guroreve në vitin 2024

Sipas informatave të marra nga inspektorati i KPMM-së gjendja e rikultivimit dhe mbylljes së minierave/guroreve pas shqyrtimit të lëndëve për mbylljen e aktivitetit minierar është si në tabelë 6.

Tab. 6. Rikultivimi dhe mbyllja e minierave/guroreve

Rikultivimi dhe mbyllja	Nr. I Licencave
Rikultivimi dhe mbyllja	4

Realizimi i të hyrave nga renta minerare

Në realizimin e të hyrave nga renta minerare në këtë vit në veçanti ndikim të madh kanë pas ndërmarrjet: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me shumën 23,736,075.99 € dhe "Sharr Cem" ShPK. me shumën 89,343.30 €, si dhe shfrytëzimi i shkëmbinjve të fortë nga ndërmarrjet e ndryshme, me qëllim të ngritjes së infrastrukturës rrugore, ndërtimore etj.

Ndikimi i sektorit minerare në çështjen sociale dhe ekonomike të vendit

Sektori i mineraleve ndryshon nga industritë e tjera në atë se lokacioni i operimeve diktohet nga faktorë gjeologjikë, çka në fakt do të thotë se aktivitetet minerare nuk mund të zhvendosen në vende tjera ku operimet e tilla kishin me qenë me shpenzime më të ulëta.

Anasjelltas, industria minerare ka potencialin për të krijuar mundësi të punësimeve afatgjata. Ndërmarrjet e licencuara në KPMM, në raportimet vjetore janë të obliguara që të raportojnë dhe për numrin e të punësuarve. Numri i punëtorëve të angazhuar në dhe rreth aktiviteteve minerare është rreth 15,000 të punësuar. Pra mund të thuhet se përkundër gjendjes jo të volitshme në të cilën është sektori minerare nuk mund të mohohet ndikimi i tij në çështjen sociale dhe zhvillimin e shoqërisë. Zhvillimi i minierave përveç ndikimit në punësim dhe çështje sociale të punëtorëve, ka ndikim dhe në buxhetin e shtetit me rreth 27,399,649.08 € rentë për shfrytëzimin e mineraleve (periudha: më 1 janar 2024 deri më 28 dhjetor 2024). Aktiviteti minerar po ashtu ka ndikim indirekt në rritjen e buxhetit për rreth 100,000,000.00 €- 120,000,000.00 € në vit. Ndikimi indirekt në rritjen e buxhetit bazohet në veprimtarin e ripërpunimit të lëndëve minerale në aktivitete të ndryshme.

Ndikimi i aktiviteteve minerare në mjedis

Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit gjatë hulumtimit, shfrytëzimit, pasurimit dhe përpunimit të resurseve minerale duhet t'i përmbahet legjislacionit në fuqi si: Ligji për Miniera Minerale Nr.03/L-163 Neni 74 respektivisht Ligjit Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03/L-214 viti 2010, Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr.02/L-102 viti 2007, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 viti 2009, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr.03/L-160 viti 2010.

Mjedisi ku zhvillohen aktivitetet minerare me tërë kompleksitetin që posedon gjithmonë tërheq vëmendjen e të gjitha institucioneve të vendit dhe angazhimi në këtë drejtim është i përhershëm. Gjatë vitit 2024 nuk ka pas ndonjë aksident mjedisor si pasojë e aktiviteteve minerare. Vlen të theksohet se flotacionet dhe fabrikat e përpunimit të agregateve duhet të investojnë edhe më tepër në evitimin e ndotjeve të cilat vijnë si rezultat i punës së tyre, pra më pak mbetje teknologjike të dëmshme dhe më pak pluhur për mjedisin ku veprojnë.

III. TREGUESIT KRYESORË TË NDIKIMIT TË MASAVE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Në vazhdim paraqiten disa nga treguesit kryesorë të ndikimit të masave të secilit objektiv strategjik.

Objektivi Strategjik: Krijimi i Kushteve të Favorshme për Valorizimin Ekonomik të Resurseve Minerale dhe Tërheqjen e Investimeve

Në zbatim të këtij objektiv, aktivitete që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim të kënaqshëm të objektivit. Masat e planifikuara për arritjen e objektivit të përcaktuara për vitin 2024, kanë ndikuar në krijimin e kushteve të favorshme për valorizimin ekonomik të resurseve minerale dhe tërheqjen e investimeve. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Sasia e lëndës minerale-koncentratit të eksportuar dhe importuar në periudhën më 1 janar 24 deri më datë 17 dhjetor 2024 sipas Doganës së Republikës së Kosovës dhe Planit të Menagjimit të Resurseve të Republikës së Kosovës 2025, KPMM;
 - Vlera e eksportit për produktet minerale për vitin 2024 është 14,748,940.06 €.
 - Vlera e Importit për produktet minerale për vitin 2024 është; 5,517,490 €.
- Licencat aktive të shfrytëzimit sipas lëndëve minerale janë gjithsej njëqind e njëzet e dy (122) licenca Raporti Vjetor i KPMM-së, më 21 nëntor 2024. PMRK 2024, KPMM;
- Aplikacione për licenca të hulumtimit të lëndëve minerale kanë qenë nëntë dhjetë e nëntë (99). Licencat aktive të hulumtimit të lëndëve minerale janë tetëdhjetë e katër (84), gjendja më datën 21 nëntor 2024. PMRK 2024, KPMM;
- Aplikacionet për aktivitete të veçanta gjatë vitit 2024 janë tetëdhjetë e dy (82), gjendja më datën 21 nëntor 2024 Lejet e aktiviteteve të veçanta gjithsej shtatëdhjetë e pesë (75) leje për aktivitete të veçanta ku mbizotërojnë tridhjetë e katër (34) leje për sortues, njëzet e tetë (28) për baza të betonit dhe njëmbëdhjetë (11) leje për bazat e asfaltit. PMRK 2024, KPMM;
- Regjistrimi i njëzet e një (21) ndërmarrjeve të reja në fushën e xehetari dhe gurëthyes sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara sipas muajve dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomik, dhjetor 2024 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK);
- Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 783.53 mijë ton ose tetë pikë shtatëdhjetë e katër për qind (8.74%) më shumë se në muajin e njëjtë të vitit paraprak. Sipas, statistikave të energjisë dhjetor 2024 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Objektivi Strategjik: Rritja e Kapaciteteve Njerëzore dhe Institucionale në Fushën e Sektorit Minerar

Në zbatim të këtij objektiv, aktivitetet që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim jo të kënaqshëm të objektivit. Masat e planifikuara për arritjen e objektivit të përcaktuara për periudhën 2021-2024, kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në fushën e sektorit minerar. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Rritja e numrit të të diplomuarve në sektorin minerar në njëzet e shtatë (27) të nivelit Baçeller, kemi një rritje prej pesëdhjetë për qind (50 %) dhe katërmëdhjetë (14) të nivelit Master. Gjithsejtë dyzet e një (41) kuadro të ri Akademike, sipas Raporti Vjetor i UIBM-së 2024;
- Në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) ShA janë pranuar dyqind e njëzet (220) punonjës të ri në pozita të shiritave transportues, hinkës fushore dhe kabinës.

Objektivi Strategjik :Çështjet Sociale dhe Përfitimet e Komunitetit

Në zbatim të këtij objektivi, aktivitete që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim të kënaqshëm të objektivit. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Subvencionimi i Skemave e pensioneve të Minatorëve të “Trepçës” me 1,118 përfitues sipas, Statistikat e Mirëqenies Sociale dhjetor 2024 Agjencia e Statistikave të Kosovës ASK;
- Aplikimi i standardeve dhe rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë për pesëdhjetë për qind (50%);
- Rritja e investimeve dhe përfitimeve të komunitetit nga veprimtaria minerare duke përfituar njëzetë për qind (20%) nga rentat minerare.

Objektivi Strategjik: Përkujdesja për Mjedisin

Në zbatim të këtij objektivi, aktivitete që janë kryer plotësisht janë treguesit kryesorë të ndikimit të masave duke konstatuar një realizim jo të kënaqshëm të objektivit. Kjo është arritur përmes tregueseve si më poshtë:

- Aplikimi i standardeve mjedisore në sektorin minerar për pesëdhjetë për qind (50 %); Operoret minerare janë të obliguar të zbatojnë standardet mjedisore konform licencave për zhvillimin e aktiviteteve minerare. Mbikëqyrja e zbatimit të këtyre standardeve është përgjegjësi e inspektoratit për miniera.
- Adoptimi dhe zbatimi i standardeve mjedisore të BE-së në sektorin minerar në pesëdhjetë për qind (50%); Standardet mjedisore të cilat aplikohen në vendet e BE-së, janë standarde të cilat draftohen, harmonizohen dhe adaptohen nga Organizata Evropiane e Standardeve, CEN, Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS) i adapton këto standarde si Standarde Kosovare (SK).
- Reduktimi i sasisë së mbeturinave të gjeneruara dhe të rrezikshme nga aktivitetet minerare - xehetari dhe gurëthyes në 2.795.809 tonë. Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të rrezikshme, nga kompanitë me dhjetë (10) ose më shumë punëtorë gjatë periudhës 2013-2020 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2024.

IV. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Rreziqet e hasura gjatë monitorimit të këtij dokumenti lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorët e tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.

Rrezik më i zakonshëm në aktivitetet e tyre të përgjithshme të institucioneve, gjegjësisht ndërmarrjeve minerare, në drejtim të realizimit të projekteve të Programit për Zbatimin e Strategjisë Minerare (PZSM) për vitin 2024, bazuar në takimet dhe diskutimet e përbashkëta, vlerësohet të jetë mungesa e mjeteve financiare.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit dhe Programit për Zbatimin e Strategjisë Minerare (PZSM) për periudhën 2022-2024, Ministria e Ekonomisë (ME), respektivisht Departamenti i Minierave (DM), ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit për vitin 2024, ndërsa, në hartimin e këtij dokumenti kanë marrë inputet dhe janë identifikuar rreziqet për të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. Si pjesë e kësaj do të vazhdoj bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit minerar në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

Mund të konstatohet se ngecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregojnë për domosdoshmërinë marrja e hapave konkret në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e këtij sektori. Roli i institucioneve përgjegjëse të sektorit minerar por edhe i ndërmarrjeve minerare në planifikimin e aktiviteteve dhe projekteve është jetik në suksesin dhe zhvillimin e sektorit minerar. Në këtë drejtim duhet forcuar kapacitetet institucionale përmes ngritjeve profesionale dhe investimeve në zhvillimin e teknologjisë. Po ashtu në suksesin e sektorit rol të rëndësishëm luan transparenca dhe lehtësimi i proceduarve burokratike. Në këtë drejtim duhet krijuar mundësitë institucionale që investorët të kenë qasje të lehtë dhe të shpejt në interesat e tyre për investime duke pasur një adresë të qartë ku mund të drejtojnë kërkesat e tyre. Harmonizimi i ligjeve dhe heqja e paqartësive ligjore, bashkëpunimi më i ngushtë dhe i vazhdueshëm, hulumtimi i mundësive të reja për donacione dhe tërheqje të fondeve janë disa nga hapat e domosdoshëm që duhet të ndërmerren në vitet në vazhdim në këtë drejtim.

Sfidat, mangësitë dhe pengesat

Sfidat, mangësitë dhe pengesat e hasura gjatë monitorimit të këtij dokumenti lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorët e tjerë të jashtëm që ndikojnë në nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik.

Sfida më e zakonshme në aktivitetet e tyre të përgjithshme të institucioneve, gjegjësisht ndërmarrjeve minerare, në drejtim të realizimit të Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025 për vitin 2024, bazuar në takimet dhe diskutimet e përbashkëta, vlerësohet të jetë mungesa e mjeteve financiare.

Sfida tjera dhe mangësi tjera mund të quhen edhe performanca institucionale menaxhuese, aftësitë profesionale, procedurat burokratike të ndërlikuar me procedurat e ndërlikuara të pajisjes me licencë, për zhvillimin e aktivitetit minerar (në kuptimin e përfshirjes të shumë institucioneve që sipas tyre

shpeshherë kanë rënë në kundërshtim me njëra-tjetrën, për sa i përket interpretimeve të ligjeve që e rregullojnë fushën përkatëse).

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë dhe të dhënat e përshkruar në tabelat më lart mund të konstatohet se është shënuar një progres i kënaqshëm i disa institucioneve si indikator i përgjithshëm i Progresit të Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM). Ngjecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregon për mangësitë në planifikimin e projekteve nga ana e ndërmarrjeve dhe institucioneve të sektorit minerar por edhe në punën e institucioneve përgjegjëse në eliminimin e barrierave që pengoj zhvillim e këtij sektori.

Resurset buxhetore

Pjesa më e madhe apo mbi nëntëdhjetë për qind (90%) e buxhetit që parashihen të shpenzohen në zbatimin e Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025, është nga Ndërmarrjet Publike (NP) dhe private minerare. Vetëm një pjesë e vogël e kostos së zbatimit të Programi i Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM), është mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK). Nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK), kryesisht janë mbuluar projektet për Ndërmarrjet Publike (NP) si "Trepça" ShA dhe projektet nga institucionet e sektorit minerar.

Konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm

Mund të thuhet se disa nga institucionet dhe ndërmarrjet minerare nuk kanë analizuar në mënyrë të mjaftueshme burimin e financimit të projekteve përkatëse, që më vonë ka rezultuar me mosrealizimin e projekteve të caktuara si pasojë e mungesës së mjeteve financiare.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë dhe të dhënat e përshkruar në tabelat më lart mund të konstatohet se është shënuar një progres i kënaqshëm i disa institucioneve si indikator i përgjithshëm i Progresit të Zbatimit të Strategjisë Minerare (PZSM). Ngjecjet në realizimin e disa projekteve të parapara, tregon për mangësitë në planifikimin e projekteve nga ana e ndërmarrjeve dhe institucioneve të sektorit minerar por edhe në punën e institucioneve përgjegjëse në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e këtij sektori.

Rekomandimet dhe hapat e ardhshëm bazuar edhe në shqetësimet e paraqitura nga kompanitë e sektorit minerar, janë të ndërlydhura me lehtësimin e procedurave të pajisjes me licencë, për zhvillimin e aktivitetit minerar në kuptimin e përfshirjes të shumë institucioneve që sipas tyre shpeshherë kanë rënë në kundërshtim me njëra - tjetrën, për sa i përket interpretimeve të ligjeve që e rregullojnë fushën përkatëse.

Disa nga rekomandimet dhe hapat e ardhshme janë:

- Mbrotja e resurseve minerale si një pasuri kombëtare nga ndërtimi i objekteve të ndryshme mbi resurse apo në afërsi të tyre në favor të shfrytëzimit racional të resurseve minerale në funksion të zhvillimit ekonomik kombëtar;
- Miratimi i një Udhëzimi Administrativ (UA) për shfrytëzim racional të resursit me interes më të mirë të shtetit, duke pasur parasysh interesin publik të nevojshëm në konservimin e resursit në gjendje aktuale respektivisht në mbrotje të mjedisit;
- Nxitja e hulumtimeve sidomos të mineraleve metalore duhet të jetë prioritet edhe vitin vijues në mënyrë që të zgjerohet baza e rezervave të këtyre lëndëve;
- Hartimi i politikave për shfrytëzim racional sidomos atyre ndërtimore dhe industriale në koordinim me planet zhvillimore komunale në secilin region të Kosovës, si plane të gurove;
- Zhvillimi i "Zonave me interes të veçantë mineral" duke krijuar mundësi për investime në këto zona;
- Të shqyrtohet mundësia e riciklimit të mbetjeve nga veprimtaria minerare (në pajtueshmëri me legjislacionin aktual, Rregullorja Nr.02/2012 për Administrimin e Mbeturinave Minerare), ndërtimet, rindërtimet, riparimet dhe shkatërrimet e ndërtesave apo konstruksioneve të tjera e që njihen si mbetje inerte (materialet si: gurë, beton, tjegulla, etj.);
- Zhvillimi i sektorit përpunues me prioritet të veçantë tek mineralet metalore, energjetike dhe ato industriale duke i dhënë rëndësi të veçantë teknologjive të reja përpunuese dhe pastruese;
- Të investohet më shumë në menaxhimin e mirëfillt të resurseve minerale dhe burimeve njerëzore për sektorin minerarë.

V. SHTOJCA I- PJESA MATRICORE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2024, TË STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2012-2025

Në këtë shtojcë jepen informata mbi statusin e zbatimit të veprimeve, bashkë me një përshkrim të shkurtër të progresit në çdo veprim/aktivitet, treguesit e produktit (Output), ndonjë problem të identifikuar dhe hapat e propozuar të ardhshëm.

1. OBJEKTIVI STRATEGJIK: KRIJIMI I KUSHTEVE TË FAVORSHME PËR VALORIZIMIN EKONOMIK TË RESURSEVE MINERALE DHE TËRHEQJEN E INVESTIMEVE							
1.1 Objektivi specifik: Plotësimi i Infrastrukturës Ligjore dhe Rregullator							
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA).	Progresi në zbatim
1.1.1	Avancimi i kornizës ligjore	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Plotësimi i infrastrukturës	Strategjia Minerare e	Realizimi: njëqind për qind (100 %)

dhe politik-
bërjes në
sektorin
minerar.

Hartimi i
legjislacionit
sekondar të
Shërbimit
Gjeologjik të
Kosovës
(ShGjK).

s ligjore, për
shërbime nga
ShGjK-ja.

Republikës
së
Kosovës,
për
periudhën
2012-2025.

Drafti i rishikuar i Projekt
Udhëzimit Administrativ
(UA), për përcaktimin e
tarifave të shërbimit më palën
e tretë është finalizuar dhe
dërguar në kabinet për
nënshkrim nga Ministria.
Drafti i rregullores për
organizimin e brendshëm dhe
sistematizimin e vendeve të
punës për Shërbimin
Gjeologjik të Kosovë është
dërguar në kabinet për
diskutimet e fundit.
Është finalizuar me
nënshkrimin nga ME-së.
Është lansuar në Gazetën
Zyrtare (GZ) të Republikës së
Kosovës - Udhëzimin
Administrativ (ME) Nr.
01/2022 për Mënyrën e
Mbledhjes Koleksionimit
Ruajtjes dhe Mbrojtjes së
Mineraleve me Strukturë
Kristalore Numrin dhe Llojin
e Mineraleve të Mbrojtura në
Muzeun Shtetëror të
Kristaleve dhe Mineraleve
"TREPÇA".
Drafti final i projektit.

1.2 Objektivi specifik: Hartimi i politikave zhvillimore për sektorin minerar

Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA).	Progresi në zbatim
1.2.1	Plani për Menaxhimin e Resurseve Minerale.	2024	Pa kosto	ME, KPMM.	Plani për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin 2024 i hartuar.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Realizimi: njëqind për qind (100 %). Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale për vitin 2024 është miratuar nga ME-së. Sipas Ligjit për Miniera Minerale (LMM) Nr.03/-163 neni 74 respektivisht Ligjit Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik neni 45, KPMM është e obliguar që: gjatë tremujorit të fundit të secilit vit kalendarik të përgatit dhe dorëzon në Ministrinë e Ekonomisë (ME), Projekt Planin për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin vijues, i cili duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

1.2.2	Hartimi i Raportit Vjetor të Progresit të Programit të Zbatimit të Strategjisë Minerare.	2024	Nuk ka kosto	ME	Raport Vjetor për vitin 2023 i përfunduar.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Realizimi: njëqind për qind (100 %). Vazhdon monitorimi i rregullt i Zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025. Mbi bazën e monitorimit deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2024 është hartuar dhe miratuar Raporti i Progresit për vitin 2023.
1.2.3	Promovimi i sektorit minerar.	2024	10,000,00	ME, UIBM, KPMM.	Konferenca vjetore të realizuar për "Gjeoshkencat, roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm".	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Realizimi: njëqind për qind (100 %). Sipas planifikime është mbajtur Konferenca e V-të Ndërkombëtare Multidisiplinare të Gjeoshkencave IMGC2024 më datë 10 – 11 tetor 2024 në Kampusin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, ku Ministria e Ekonomisë/Departamenti i Minierave është bashkëorganizator i kësaj konference.

OBJEKTIVI STRATEGJIK: RRRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE INSTITUCIONALE NË FUSHËN E SEKTORIT MINERAR

2.1 Objektivi specifik: Zhvillimi Institucional dhe i Kapaciteteve Njerëzore							
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA).	Progresi në zbatim
2.1.1	Aftësimi i stafit profesional në miniera mbi implementimin e rregullave teknike të mbrojtjes, dhe sigurisë në vendin e punës.	2024	Pa kosto	ME, UIBM, KPMM.	Ripërtëritjen e fuqisë punëtore në minierat aktive, si dhe aftësimi intensiv i punëtorëve dhe stafit teknik mbikëqyrës, sipas kritereve më bashkëkohore	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Kanë vazhduar aktivitetet në kuadër të identifikimit dhe realizimit të trajnimeve për sektorin minerar mbi rregullat teknike të mbrojtjes dhe sigurisë në vendin e punës. Në kuadër të kësaj tematike është duke u trajtuar mundësia që së bashku me International, Commercial Law Development Program, Office of the General Counsel, U.S. Department of Commerce të organizohen trajnime profesionale duke filluar nga pranvera e vitit 2025.

2.1. 2	KEK-u me sukses ka përfunduar procesin e rekrutimit të dyqind e njëzet (220) punonjësve të rinj.	2024	Burimi i financimit KEK-ut.	KEK	Ripërtëritjen e fuqisë punëtore në minierat aktive, si dhe aftësimi intensiv i punëtorëve dhe stafit teknik mbikëqyrës, sipas kritereve më bashkëkohore	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ShA, Gjatë vitit 2024 ka përfunduar me sukses procesin e rekrutimit të dyqind e njëzet (220) punonjësve të rinj është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për mbulimin e pozitave vakante, duke përmirësuar performancën e korporatës dhe duke kontribuar në uljen e papunësisë.
-----------	--	------	-----------------------------	-----	---	--	---

2.2 Objektivi specifik: Hulumtimi i Resurseve Minerale dhe Raportimi i Tyre							
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA)	Progresi në zbatim
2.2. 1	Projekti: Plansheti Gjeologjik i Ponoshecit në shkallë 1: 25000	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Plotësimi i informacioneve, për shërbime nga ShGjK-ja.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Në projektin Plansheti "Ponoshec", "K34-53Dc, në shkallë 1:25 000 është duke u punuar në vazhdimësi. Gjatë periudhës për të cilën raportojmë është bërë punë analitike me të dhënat. Këto të dhëna sistematikisht janë duke i vendosur dhe plotësuar në dokumentin final që është duke u përgatitur, dhe i cili është paraparë të përfundojë gjatë këtij viti. Mostrat e marra gjatë itinerareve të fundit do të përgatiten, sistemohen dhe evidentohen dërgohen gjatë javëve në vijim për tu përpunuar në Laboratorin e Gjeomekanikës në Mitrovicë". Projekti është realizuar njëqind për qind (100 %).
2.2. 2	Hulumtimi i relikteve minerale të skorieve, analizimi dhe krijimi i hartës 1:100000 për vitet 2023-2024.	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Plotësimi i informacioneve të data bazës, për shërbime nga ShGjK-ja.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Mbledhja e mostrave në pika të ndryshme metalurgjike. Analizimi i relikteve minerale dhe krijimi i hartës se relikteve në përdorim të GIS-it dhe vendosjen e simboleve në hartë.
2.2. 3	Harta e rrezikut sizmik për territorin e Kosovës për vitet 2023-2024.	2024	Pa kosto	ME ShGjK	Plotësimi i informacioneve të data bazës, për shërbime nga ShGjK-ja.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Projekti është realizuar njëqind për qind (100 %). Analiza e tektonikes dhe gjeologjisë në territorin Republikës së Kosovës, Klasifikimi, modelimi matematikor dhe probalistik i rrezikut.

3. OBJEKTIVI STRATEGJIK: ÇËSHTJET SOCIALE DHE PËRFITIMET E KOMUNITETIT

3.1 Objektivi specifik		Trajtimi i Çështjeve Sociale dhe Siguria në Punë					
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA).	Progresi në zbatim
3.1.1	Mbështetje e Ndërmarrjes Publike- "Trepça" ShA.	2024	ME	ME TREPÇA	Subvencionimi i pagave.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Gjatë vitit 2024 ME-ja ka subvencionuar Ndërmarrjen Publike (NP) "Trepça" me shumën 9,870,915,71 €.
3.1.2	Përkrahja e studentëve dhe hulumtimeve nga KEK-u.	2024	KEK-ShA	KEK ShA	Ngritja e kapaciteteve institucionale.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) vazhdon të mbështesë bashkëpunimin e ngushtë me universitetet dhe studentët, duke kontribuar në zhvillimin e projekteve hulumtuese që kanë ndikim pozitiv për industrinë dhe mjedisin.

4. OBJEKTIVI STRATEGJIK: PËRKUJDESJA PËR MJEDISIN

4.1 Objektivi specifik:		Zgjidhja e Problemeve Mjedisore Historike					
Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente (p.sh. PPQ, PKZMSA).	Progresi në zbatim
4.1.1	Mbrojtja e mjedisit dhe trajtimi i çështjeve sociale.	2024	KEK	KEK	Projektet ambientale të përfunduara.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	KEK-u vazhdon me pastrimin e binareve Industriale. Njësia për Menaxhimin e Projekteve, Pastrimin dhe Rikultivimin e Tokave (NJMPPT), ka filluar pastrimin e binareve industriale më datë 18 nëntor 2024. Pastrimi i binarëve industrialë të TC "Kosova B" po vazhdon të zhvillohet sipas planit dinamik dhe aktualisht është duke u realizuar nga Obiliqi në drejtim të fshatit Plemetin. Pastrimi i fundit i realizuar ka përfshirë largimin e masave të dheut, shkurreve dhe barishteve përgjatë vijës së infrastrukturës së hekurudhës industriale. Kanë vazhduar aktivitetet në terren rreth inspektimeve të rregullta që kanë të bëjnë me çështje mjedisore

							në njësi prodhuese brenda KEK-ut.
4.1. 2.	Realizimi i politikave mjedisore në KEK.	2024	KEK	KEK	Projektet ambientale të përfunduara.	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025	Ka vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikimit dhe përgatitjes së hapësirave në Parkun KEK-u, i II-të në një sipërfaqe rreth njëzet (20) hektar, rregullimi i rrjedhave dhe pellgjeve ujore, është shtuar fondi i drunjëve n137 këto hapësira. Janë mirëmbajtur hapësirat e TC "Kosova A" dhe Zonës së Seperimeve Kimike, janë ruajtur, si dhe mirëmbajtur plantacionet në Lismir. Kanë vazhduar aktivitetet e prokurimit për grumbullimi, ambalazhimi dhe magazinimi i mbetjeve dhe materialeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral në hapësirat e TC "Kosova B", TC "Kosova A" dhe DPQ, projekt ky që do të ndikoj në zvogëlimin e ndjeshëm të rrezikut për punëtorët e KEK-ut, dhe banoret e zonës.